



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
NJËSIA E PROKURIMIT**

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **SHERBIMI I INTERNETIT**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 72400000-4 -  
Shërbimet e internetit,

**FONDI LIMIT I MARREVESHJES KUADER VLERA E PRITSHME E KONTRATËS/  
KONTRATAVE: 4,194,000(KATERMILION E NJEQIND E NENTEDHJETE E  
KATERMIJE ) LEKE PA TVSH..**

**KOHËZGJATJA E KONTRATËS/MARRËVESHJES KUADËR OSE AFATI PËR  
ZBATIMIN E SAJ:36(TRIDHJETE E GJASHTEMIJE).**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76 ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbështetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit e konkretisht **1,677,600** (Njemilion e gjashtëqind e shtatedhjetë e shtatemije e gjashtëqind) lekë.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” “*Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten*”, “*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në*

procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se (Njemilion e gjashtëqind e shtatedhjetë e shtatemije e gjashtëqind) lekë që është 40% e vlerës së fondit limit lotit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës/lotit, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021, 2022 dhe 2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin Mbi Të Ardhurat”, të Ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht **838,800** (teteqind e tridhjetë e tetemije e teteqind) lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. *ne lidhje me aftësite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën si dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar, vlera për shërbime të ngjashme prej **838,800** (teteqind e tridhjetë e tetemije e teteqind) lekë përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmerinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 20% të fondit limit.

- 2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në AKEP për shërbimet e ofruara dhe për këtë duhet të paraqesë certifikatën e regjistrimit pranë AKEP.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, *”Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim”* nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe ligjit Nr. 9918 datë 19/05/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

- 2.3.3** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 9001:2015(Certifikata e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë),Certifikata duhet të jetë e leshuar nga organet e vlerësimit të konformitetit dhe i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë .

- 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 27001:2013( Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ose të përditësuar), Certifikata duhet të jetë e leshuar nga organet e vlerësimit të konformitetit dhe i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

*Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.*

Certifikimi ISO 27001:2013 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjale duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe që kanë një rendësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshem e i kodifikuar). Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Kjo vjen pasi në këte kontratë do ketë edhe furnizime të reja ashtu si edhe migrim të dhenash/mirembajtje e upgrade të sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këte drejtim.

- 2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë AS e tij të regjistruar pranë RIPE NCC (European IP Networks) Minimumi i Uplink providers me te cilet lidhet Operatori duhet te jete 2 , ku te pakten njeri duhet te jete international.Te paraqitet dhe gafikisht lidhja e AS number te Operatorit me AS numbers te Uplink providers.Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikat/Kontrate ose Marrëveshjen përkatëse.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ”Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim” nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar,

Operatori ekonomik duhet të ofrojë për autoritetin kontraktor besim, siguri dhe garanci për cilësinë dhe vazhdimësinë e shërbimit të vazhdueshëm dhe pa ndërprerje me internet për të realizuar objektin e prokurimit, sic kërkohej në Specifikimet teknike.

- 2.3.6** Operatori ekonomik i interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet që për çdo linjë (primare dhe Back-up) të hartojë një dokument në të cilin të përshkruajë llojin e lidhjes (Fibër, Radio, etj) dhe pajisjet fundore që do të përdori (Router, Antenë, etj). Për pajisjet, Operatori Ekonomik duhet të specifikojë Markën dhe Modelin e pajisjes.Për pajisjen Router duhet te paraqese katalogun e prodhuesit ku te shprehen qarte karakteristikat teknike te routerit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar,pika 4 dhe nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,pika 4.

Këto informacione janë të nevojshme për të kuptuar paraprakisht nëse lloji i lidhjes dhe paisja fundore që ofrohet nga O.E i përmbush specifikimet teknike si dhene për ti paraprirë, nëse është e nevojshem, ndonjë ndryshimi në rrjetin e brendshëm të Autoritetit Kontraktor.Nisur nga rendesi qe ka Bashkia Qender ne rrjetin e AK si dhe duke pasur parasysh sherbimet te hostuar ne serverat e Bashkise Qender, specifikimet teknike te pajisjes ne fjale na ndihmojne per ti paraprire, nese eshte e nevojshme, ndryshime apo konfigurime me qe qellim qe te shmangim problematiakt ne ofrimin e sherbimit

**2.3.7** Operatori ekonomik i interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të paraqesë një plan pune të detajuar për realizimin e shërbimit të kërkuar me detyrat, afatet kohore dhe stafin përgjegjës.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar,pika 4 dhe nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,pika 4.

Nisur nga rendesia qe sherbimi i internetit ka per mbarvajtjen e punes se AK, nje inforamacion i tille na jep mundesine e marrjes së masave, nese eshte e nevojshme, gjate procesit te tranzicionit te sherbimit nga nje operator tek nje operator tjetër.

**2.3.8** Operatorët ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të deklarojnë se marrin përsipër të realizojnë lidhjen e shërbimit në një afat kohor 2 javor nga data e nënshkrimit të kontratës.

**2.3.9** Operatoret ekonomik duhe të deklarojnë se jane te gatshëm të shtojë/të ndryshojë pika të reja/egzistuese ofrimi shërbimi interneti në varësi të kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Këto pika duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike. Koha e instalimit te linjave te reja duhet të jetë jo më shumë se 3 (tre) ditë nga data e njoftimit të Operatorit Ekonomik

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteri i vendosur garanton autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë,



përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë për autoritetin kontraktor besim, siguri dhe garanci për cilësinë e pajisjeve të sigurisë të cilat shërbejnë për të realizuar objektin e prokurimit, siç kërkohej në Specifikimet teknike.)

Nisur nga fakti se kontrata është 36 muaj dhe nga fakti që AK ka për qëllim që të mundësojë shërbimet e tij sa më afër qytetit, herë pas herë lind nevoja shërbimet të AK të shtohen apo të shtohen. Duke qenë se ky është një proces dinamik është kërkuar që operatori të jetë i gatshëm të bejë shtimin/ndryshimin e pikave të reja/egzistuese

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*